



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 67 prot.

Kamëz, më 19.05.2022

V E N D I M

Nr. 57, Datë 19/05 2022

MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË NË VAZHDIM”, PËR VITIN 2022 ME FONDE TË BUXHETIT TË SHTETIT”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.05.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.54 Datë 18.05.2022 Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr.47, datë 19.04.2022, të Këshillit Bashkiak “Mbi disa ndryshime në VKB nr. 66 Datë 25.06.2020 Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit ”Subvencionimi i interesave të Kredisë” i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, VKB nr.65 dt.25.06.2020 “Për ngritjen e komisionit të strehimit”, të vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, vendimit nr. 453, datë 3.7.2019 të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, shkresës nr.1237 Protodatë 24.01.2022 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2022”, bazuar në raportin përmbledhës të Komisionit të Strehimit menr.4399 Protodatë 17.05.2022, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Listën e familjeve që përfitojnë nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim”, për vitin 2022, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1, të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucionit bankar, brenda 6 (muajve) nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz. Mos respektimi i këtij afati është shkak për s’kualifikimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
HYSEN KOLDASHI

